

MIRANDA HAXHIA



Audituese e Lartë. Departamenti i Auditimit të Pushtetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, në KLSH. Lindur në vitin 1964. Diplomuar në Jurisprudencë(1987). Eksperiencë pune: 25 vjet. Master në formim diplomatik, Marrëdhënie & Studime Evropiane
Eksperiencë pune në KLSH 10 vjet:
Fusha e ekspertizës: Prokurimet Publike

KONTROLI I LARTË I SHTETIT-ROJE E FINANCEVE PUBLIKE¹

nga Miranda Haxhia

Në aktivitetin e përditshëm publik, jo rrallë herë ndodh që KLSH të shihet si organ represiv dhe misioni i tij “Auditimi i njësive dhe programeve publike në përputhje me standardet ndërkombëtare të përditësuar të auditimit, të miratuara nga INTOSAI dhe me praktikat më të mira evropiane, për t’i siguruar Kuvendit, grupeve të interes dhe publikut të gjerë që burimet e sektorit publik janë përdorur sipas ligjit, në mënyrë ekonomike, me efektivitet dhe me efikasitet”¹, të njehsohet me objektivin e organeve të prokurorisë apo ato të inspektimit të dikurshëm të shtetit. Kjo për faktin, se shpesh kërkohet nga KLSH, sidomos nga shtypi periodik që në denoncimin e akteve abusive dhe korrupsionit të dalin dhe “emra” të punonjësve përgjegjës, njëkohë që KLSH nxjerr në pah ndryshimin mes asaj që është

¹Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të KLSH, miratuar me Vendimin nr.53, datë 16.4.2012, neni 4.2.

dhe asaj që duhet të jetë. Personat përgjegjës për aktet abuzive dërgohen para organeve të prokurorisë.

KLSH, është roje e financave publike dhe “auditimi”, si thelbi i ekzistencës së këtij institucioni, është nxjerrja e ndryshimit midis asaj që duhet të jetë dhe asaj që është në të vërtetë, nuk ka rëndësi në se është “auditim i jashtëm” apo “auditim i brendshëm”.

Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr. 8270, dt. 23.12.1977 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, KLSH është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Republikën e Shqipërisë². Objekt kryesor i punës së KLSH, përcaktohet auditimi i përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, mirëadministrimi financiar dhe zbatimi i ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare.

Me ardhjen në krye të KLSH, z. Bujar LESKAJ nënvizoi si “një ndër sfidat për një vizion modern të auditimit në Shqipëri, kthimin e vëmendjes tek auditimi i performancës, krahas konsolidimit të auditimit financiar, duke e cilësuar atë si një ndër shtyllat kryesore të planit strategjik 2012-2015”³. Në përgjigje të kësaj sfide qëndron dhe krijimi i Departamentit të Auditimit të Performancës duke u shtuar si një shtyllë bazë në krah të departamenteve të tjera të auditimit, si një risi që duke thyer barrierat e kohës dhe mendësitë mesquine të ambientit rrit dhe numrin e auditimeve të performancës.

²Neni 162 I Kushtetutës

³Nga materiali i paraqitur nga Dr. Bujar Leskaj pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, me datë 14 Dhjetor 2011, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për Kryetar të KLSH

Sfida vazhdon e fortë dhe tërheq dhe veëmendjen e familje së madhe europiane. Në Progres-Raportin e KE për Shqipërinë, shkruhet qartë dhe pa mëdyshje se “.....ka patur progres në fushën e auditimit të jashtëm. Një Kryetar i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit u emërua nga Parlamenti në dhjetor 2011. Pas disa viteve ngecje,KLSH i kryen të gjitha llojet kryesore të auditimeve...”⁴. Në këtë mënyrë KLSH përmbush me rigorozitet standardet e INTOSAI-t.

Rritja e performancës institucionale forcon bindshëm rolin e KLSH si roje e financave publike duke qënë larg të qenurit organ represiv por një vlerë e shtuar për të nxjerrë ndryshimin midis asaj që duhet të jetë dhe asaj që është në të vërtetë, duke qënë një institucion i pavarur mekanizmi i të cilit është transparenca dhe llogaridhënia të cilat janë të domosdoshme në luftën kundër korrupsionit.

Korrupsioni i vendosur si koncept në sektorin publik i cili i shprehur në terma më konkrete është $K=M+D-P-T$ ose e thënë me fjalë të tjera: monopol ,pushtet plus liri veprimi(diskrecion), minus përgjegjshmëri, minus transparencë,⁵ është një çështje komplekse, e cila në se nuk minimizohet bëhet gangrenë e administrates publike. KLSH –ja luan një rol të rëndesishem në luftën kundër korrupsionit, por jo si organ represioni por si roje e financave publike.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 03 Korrik, 2013

⁴ Nga Progres-Raporti i KE për Shqipërinë.

⁵ “Kuptimi mbi mashtrimin dhe korrupsionin” nga Manuali “Hetimi Administrativ i veprave penal e të korrupsionit të interesave private “. USAID.